

Nr. 714 Prot.  
Tiranë më 23/08/2024

Nr. 471 Prot.  
Tiranë më 26/08/2024

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

DHE

INSTITUTIT KANADEZ TË TEKNOLOGJISË

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dakordësuar ndërmjet palëve të mëposhtme:

- a) Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (në vijim "AKSK"), me adresë rruga "Papa Gjon Pali II", Nr.3, Tiranë përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Igli Tafa; dhe
- b) Institutit Kanadez të Teknologjisë (në vijim CIT) me adresë rruga "Xhanfize Keko" Nr.12, Tiranë, përfaqësuar nga Rektori i Kolegjit Universitar, prof.Dr. Ismail Kocayusufoglu;

**Duke pranuar** se Teknologjitet e Informacionit dhe të Komunikimit (TIK) kanë hapur dritare të reja mundësish dhe janë mjete thelbësore për zhvillimin socio-ekonomik të vendeve në mbarë botën;

**Duke pranuar** se TIK kanë sjellë gjithashtu lloje të reja kërcënimesh si: krimi kibernetik, spiunazhi kibernetik, aktivizimi, terrorizmi kibernetik, lufta kibernetike, sulmet ndaj infrastrukturës kritike, fushat e dezinformimit; dhe se këto kërcënime janë në rritje globalisht, ndërkombeartarish, në mënyrë dinamike dhe po shfaqen gjithnjë e më të sofistikuara;

**Palët** angazhohen të promovojnë sigurinë kibernetike dhe të mbështesin zhvillimin e teknologjive informative;

**Palët** bien dakord të bashkëpunojnë në fushën e informacionit bazuar në përfitime të njëjtë dhe reciproke, për të përmirësuar bashkëpunimin në rritjen e kapaciteteve profesionale;

**Palët** synojnë të bashkëpunojnë për të adresuar sfidat e sigurisë kibernetike dhe për të promovuar njohuritë dhe praktikat më të mira në këtë fushë.

Palët synojnë të përcaktojnë qëllimet kryesore, objektivat, fushat dhe format e bashkëpunimit, të përfshira në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi për sa vijon.

**Neni 1**

**QËLLIMI**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ka për qëllim të promovojë bashkëpunimin në fushën e sigurisë kibernetike ndërmjet Palëve si dhe të përmirësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve në lidhje me sigurinë kibernetike bazuar në specifikimet sipas Nenit 4 të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi.

**Neni 2**

**STATUSI DHE FUSHA E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT**

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përcakton kornizën brenda të cilës Palët synojnë të bashkëpunojnë për të arritur qëllimet e përcaktuara në nenin 1.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nuk ka për qëllim të krijojë, mbajë ose imponojë të drejta dhe detyrime ligjore ndaj Palëve ose ndërmjet Palëve të treta. Zbatimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi nga Palët e përcaktuara në të, i nënshtronet përcaktimeve ligjore në fuqi.

**Neni 3**

**FUSHAT E BASHKËPUNIMIT**

1. Për të arritur qëllimin e mësipërm të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi Palët synojnë të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:
  - a) Shkëmbimin e informacioneve relevante, përvojën dhe njohuritë në lidhje me zhvillimin e sigurisë kibernetike.
  - b) Organizimin e trajnimeve të përbashkëta dhe aktiviteteve të cilat do të ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve për menaxhimin dhe mbrojtjen e sigurisë kibernetike.
  - c) Shkëmbimin e materialeve edukative dhe trajnuese lidhur me sigurinë kibernetike;
  - d) Bashkëpunimin dhe koordinimin e ndërsjellëtë në lidhje me zhvillimin e seminareve teknike, edukative, trajnimeve dhe intershipit të studentëve të CIT pranë institucionit të AKSK.
  - e) Bashkëpunimin për të organizuar dhe mbështetur iniciativa të përbashkëta, duke përfshirë por jo kufizuar në shkëmbimin e ekspertëve, zhvillimin e programeve të trajnimit dhe kërkimeve të përbashkëta

#### Neni 4

#### SHKËMBIMI DHE PËRDORIMI INFORMACIONIT

1. Palët marrin përsipër të shkëmbejnë informacionin për qëllimet e kësaj Marrëveshje duke ruajtur Konfidentialitetin. Shkëmbimi i informacionit sipas kushteve të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, politikat dhe mekanizmat në fuqi të palëve.
2. Asnjëra palë nuk do të shpërndajë informacionet e marra nga Pala tjetër sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, te asnjë pale të tretë pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër.
3. Palët do të zbatojnë mbrojtjen e të dhënave personale, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
4. Palët do të caktojnë një person kontakti përgjegjës për komunikimet ndërmjet Palëve në kuadrin e kësaj marrëveshjeje.
5. Çdo aktivitet i përbashkët që përfshin pronësinë intelektuale do të dakordësohet me shkrim nga Palët për të mbrojtur interesat përkatëse.

#### Neni 5

#### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve dhe/ose negociatave ndërmjet palëve.

#### Neni 6

#### FILLIMI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet për një afat të pacaktuar dhe Palët mund ta ndërpresin atë në çdo kohë duke njofuar palën tjetër me shkrim, të paktën 30 ( tridhjetë) ditë përpara.
3. Aktivitetet që janë në proces në momentin e përfundimit të marrëveshjes, do të përfundojnë në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.
4. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të modifikohet me marrëveshje reciproke me shkrim të Palëve.
5. Një modifikim i kësaj marrëveshjeje do të hyjë në fuqi në datën e përcaktuar reciprokisht nga Palët.

Neni 7

**KOSTOT, SHPENZIMET DHE BURIME**

Çdo Palë merr përsipër shpenzimet e veta personale dhe i siguron vetes burime për ekzekutimin e kësaj marrëveshje dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të. Të gjitha aktivitetet sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, do t'i nënshtronen disponueshmërisë së burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

**TË NDRYSHME**

1. Kjo marrëveshje hartohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.
2. Kjo marrëveshje nënshkruhet në 2 (dy) kopje, 1 për secilën palë.

Neni 8

**INFORMACIONET E KONTAKTIT**

AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE	INSTITUTI TEKNOLOGJISË KANADEZ I
Emër: Esmeralda Kazia, Ilir Daka	Emër: Reis Mulita si edhe Zyra e Rektorit
Institucioni: Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike	Institucioni: Instituti Kanadez i Teknologjisë.
Telefon: +355 (0) 67 38 64 542/+355 (0) 69 29 82 151	+ 355(0) 68 22 40 414 /+355 (0) 67 40 42 042
Adresë e-mail: <a href="mailto:Esmeralda.Kazia@aksk.gov.al">Esmeralda.Kazia@aksk.gov.al</a> <a href="mailto:Ilir.Daka@aksk.gov.al">Ilir.Daka@aksk.gov.al</a>	Adresë e-mail: <a href="mailto:reis.mulita@cit.edu.al/">reis.mulita@cit.edu.al/</a> <a href="mailto:rectoroffice@cit.edu.al">rectoroffice@cit.edu.al</a>
Telefon 24/7: +355 4 22 210 39	Telefon 24/7: +355 (0) 42 22 9778
Telefon emergjencash: +355 67386 4542	Telefon emergjencash: +355 (0) 67 40 42 042
Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Tiranë, Shqipëri.	Adresa: Rruga. Xhanfize Keko, No. 12 Tirana, Albania.

Neni 10

**NËNSHKRIMI**

Marrëveshja e Bashkëpunimit nënshkruhet nga përfaqësuesit e mëposhtëm të palëve:

NËNSHKRUAR në emër të  
Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike

NËNSHKRUAR në emër të  
Institutit Kanadez të Teknologjisë

Drejtor i Përgjithshëm

Z. Igli TAFA



Rektori

Prof.Dr. Ismail KOCAJUSUFOGLU

Nënshkrimi